

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT**

PROGRAMI MËSIMOR

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI PËR GJIMNAZET - viti i dytë



Shkup, 2002.

1. IDENTIFIKIMI I TË DHËNAVE

- 1.1. Emërtimi i lëndës mësimore : GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**
- 1.2. Lloji i arsimimit të mesëm**
 - 1.2.1. Drejtimi arsimor : Për gjimnazet**
- 1.3. Diferencimi i lëndës mësimore**
 - 1.3.1. Arsimimi i përgjithshëm : lëndë e përgjithshme**
- 1.4. Viti i mësimit të lëndës mësimore**
 - 1.4.1. Viti i dytë (II)**
- 1.5. Numri i orëve të lëndës mësimore**
 - 1.5.1. Numri i orëve javore 4 orë**
 - 1.5.2. Numri i orëve vjetore 144 orë**
- 1.6. Statusi i lëndës mësimore**
 - 1.6.1. Mësimi i obligueshëm**

2. QËLLIMI I LËNDËS MËSIMORE

- 2.1. Qëllimi i përgjithshëm i lëndës mësimore**

Qëllimi i mësimit të gjuhës shqipe dhe i letërsisë synon që nxënësit, të aftësohen të komunikojnë në gjuhën letrare shqipe, t'i përvetësojnë karakteristikat thelbësore të letërsisë shqiptare dhe asaj botërore.

*** T'i aftësojë për mësim të pavarur (vetëmësim)**

- * Të komunikojnë drejt duke respektuar gjuhën letrare shqipe në jetën e përditshme, në nivel akademik dhe në nivele të tjera.
- * Të zbatojë normat gjuhësore në jetën e përditshme(me gojë dhe me shkrim), në kontekst të caktuar konkret e profesional.
- * Të kultivojnë vlerat letrare, aftësitë personale në jetën e përditshme dhe në karrierën profesionale.
- * Të mund t'i zhvillojnë aftësitë e tyre individuale për përdorimin receptiv e produktiv të gjuhës letrare shqipe në formën e shkruar dhe atë gojore.
- * Të fitojnë dituri socio- lingvistike, që do t'i ndihmojë të gjenden në situata të ndryshme.
- * Të aftësohen për shkollim të mëtutjeshëm nëpër institucionet e arsimit të lartë në aspektin profesional e shkencor.
- * Të njihen me karakteristikat e letërsisë shqiptare dhe me veçoritë e letërsive të tjera që do ta ndihmojnë njohjen reciproke të kulturave.
- * Të mund të shfrytëzojnë literaturën profesionale (broshura, revista, fjalorë, doracakë) etj.
- * Të kenë mundësi edhe më tej t'i përsosin aftësitë e tyre profesionale në sistemin e arsimimit dhe aftësimin profesional, që po bëhet gjithnjë e më interdisciplinar dhe parakusht për kërkimin e informacioneve, mësimit dhe njohjes së gjuhës dhe të letërsisë shqiptare.
- * Të zhvillojnë aftësitë e përgjithshme dhe ato të veçanta si : zgjidhjen e problemeve, aftësimin për bashkëpunim, përgjegjësinë, përshtatshmëri dhe kreativitet.
- * Të formohet personalitet me zhvillim permanent të synimeve kognitive (arsimore), psikomotorike(edukative) dhe efektive (funksionale) , e rëndësishme për qytetarin e shoqërisë civile.

2.2. QËLLIMI I VEÇANTË I MËSIMIT

Qëllimi i veçantë i mësimit të gjuhës shqipe dhe letërsisë është ky :

- * Të përvetësojnë materialin nga fusha e gjuhës shqipe dhe letërsisë .
- * Të përvetësojnë një fond të mjaftueshëm fjalësh që do të ndihmojnë komunikimin në gjuhën amtare letrare dhe do të jenë të kuptueshëm.
- * Të aftësohen të gjejnë informacione konkrete nga sfera e gjuhës dhe letërsisë me karakter të përgjithshëm ose personal.
- * Të aftësohen të bartin informacione të shkruara ose letra që do të jenë të kuptueshme, gjithashtu nxënësit do të aftësohen për thithjen e vlerave të letërsisë shqiptare dhe asaj botërore.

3 NJOHURITË E NEVOJSHME PARAPRAKE

Pasi nxënësit e kanë kryer vitin e parë, supozohet se gjatë shkollimit të mesëm(vitit të dytë), gjimnazit, i kanë përvetësuar njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e mëposhtme :

***kuptojnë globalisht materialin e gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe kanë paranjohuri optimale mbi të njëjtën dhe atë botërore.**

*** zotërojnë një fond të mjaftueshëm fjalësh dhe elementesh gramatikore që u mundëson të shprehen qartë.**

*** gjejnë informacione dhe elemente të ndryshme gjuhësore në tekste të caktuara dhe nga burime të ndryshme.**

*** mund të vjelin informacione në sferën e komunikimit, gjuhës dhe letërsisë.**

Megjithatë, duhet të potencohet se arsimtari patjetër duhet ta ketë parasysh faktin se nxënësi, edhe përkundër arsimit bazë, do të ketë nevojë për aftësim të mëtutjeshëm, veçmas në shkollat ku interesimi është më i madh.

4. PROCESI MËSIMOR

4.1. Struktura e përmbajtjeve mësimore

FUSHA PROGRAMORE: TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA (30 ORË)				
Përmbajtjet	Numri i orëve	Qëllimet konkrete Nxënësi :	Udhëzime didaktike	korelacioni mes fushave programore dhe lëndëve
<p>TREGIMI Të hyjmë në shoqëri</p> <p>Paraqesim ndjenjat tona</p> <p>Pyesim dhe përgjigjemi</p> <p>Të jemi miq me njëri tjetrin</p>	5	<p>*di të paraqesë mendimin dhe dëshirat për të ardhmen dhe perspektivën e tij. *e kupton lirinë gjatë komunikimit si me shokët në klasë ashtu edhe jashta shkollës në jetën e përditshme.</p> <p>* di t'i paraqesë pasionet e tia, të cilat pos me anë të fjalës,të zërit mund t'i paraqesë edhe me anë të gjesteve. *krijon situata, për probleme të ndryshme të jetës së nxënësit dhe të jetës së përditshme. *i kupton rregullat që duhet pasur parasysh gjatë komunikimit në këto situata,duke respektuar tolerancën dhe mirësjelljen. *din të respektojë njëri tjetrin duke planifikuar aktivitete të përbashkëta. *din t'i menjanojë konfliktet dhe propozon zgjidhje.</p>	<p>Gjatë realizimit të kësaj forme arsimtari do të sqarojë, parashtrijë pyetje,situata,probleme,me gojë apo me shkrim. *Do të përdorë mjete mësimimore tënevojshme për realizimin e saj ,si: televizorin radion,kasetofonin,kompjuterin etj. *Do të diskutohet,debatohet, dramatizohet në grupe të mëdha dhe të vogla,ose në formën individuale dhe frontale.</p>	<p>Letërsia, gjuhësia, fonetika,morfologjia, sintaksa,drejtshkrimi, komunikimi,arsimi qytetar.</p>

RITREGIMI Ngjarje të përjetuara	4	<p>*din të ritregojë ngjarje që kanë ndodhur,qoftë të mira apo trishtuese.</p> <p>*e kupton ngjarjen në lidhje të ngushtë me kohën dhe vendin ku ka ndodhur.</p> <p>*e komenton dhe ritregon ndodhinë e shikuar në një film,qoftë e mirë apo trishtuese.</p> <p>e komenton subjektin e një libri të lexuar që është i lidhur me kohën e sotme dhe tendencat për ardhmëri më të mirë.</p>	<p>*Gjatë realizimit të kësaj forme arsimtari do të sqarojë, parashtrojë pyetje,situata,probleme me gojë apo me skrim.</p> <p>*Do të përdorë mjete mësimore të nevojshme për realizimin e saj si:televizorin, radion,kasetofonin,kompjuterin etj.</p> <p>*Do të diskutohet,debatohet, dramatizohet në grupe të mëdha dhe të vogla,ose në formën individuale dhe frontale.</p>	
FILMI Libër i lexuar	7	<p>*din të organizojë diskutime për një problem të caktuar (konflikti në klasë).</p> <p>*din të bëjë vlerësimin e diskutimit duke i përcaktuar anët e mira dhe të këqija të tij.</p> <p>*din të diskutojë për problemet që janë të ndërlidhur me ekologjinë.</p> <p>-e kupton e biznesin si veprimtari ekonomike e rëndësishme për kohën e sotme.</p> <p>*e kupton atë si profesion dhe veprimtari pozitive dhe shërbyese.</p> <p>*e kupton drejt nocionin modë,rëndësinë dhe mesazhin e saj.</p>	<p>*Gjatë realizimit të kësaj forme arsimtari do të sqarojë, parashtrojë pyetje,situata, probleme,me gojë e me shkrim.</p> <p>*Do të përdorë mjete mësimore të nevojshme për realizimin e saj si:televizorin, radion,kasetofonin,kompjuterin etj.</p> <p>*Do të diskutohet,debatohet, dramatizohet në grupe të mëdha dhe të vogla,ose në formën individuale dhe frontale.</p>	
DISKUTIMI Probleme të caktuara				
EKOLOGJI BIZNESI				
MODA				

FUSHA PROGRAMORE - GJUHË 40 orë

Përmbajtjet	Numri i orëve	Qëllimet konkrete Nxënësi të :	Udhëzime didaktike	Korelacioni mes përmbajtjeve dhe lëndëve
<p>I.Leksikologji</p> <p>Fjala si njësi bazë e leksikut</p> <p>Kuptimi leksikor i fjalës</p> <p>Sinonimet, antonimet dhe homonimet</p> <p>Shtresat e leksi- kut të gjuhës shqipe</p> <p>Arkaizmat,histo rizmat,krahinar i</p>	7	<p>* dallon fjalën si njësi më e vogël dhe e mëvetësishme e gjuhës, si njësi bazë e leksikut, përmbajtjen dhe formën e fjalës.</p> <p>*të dallojë fjalët me më shumë kuptime. *të dijë se çdo fjalë duhet të ketë një kuptim të caktuar, se shumica e fjalëve, përveç kuptimit themelor, kanë edhe kuptime të tjera leksikore, p.sh këmbë - lumi, degë - lumi etj.</p> <p>* dallon sinonimet, antonimet dhe homonimet në tekste të ndryshme letrare dhe artistike si dhe në tekste tjera.</p> <p>*të dijë të dallojë fjalët e shtresës vetjake dhe të huazuara si p.sh. mjek - medicus, qytet - civitas etj</p> <p>*dallon shtresën e përgjithshme (fjalët që i përdor populli) dhe rastet e kufizuara (fjalët e vjetruara, të dialekteve e të krahinave të nryshme,profesionale etj.)</p>	<p>Për realizimin e kësaj përmbajtje- je arsimtari do të përdorë këto aktivitete: *sqarimin,analizën,ushtrimin, hulumtimin,grumbullimin e materialeve,krahasimin etj. Do të përdorë format mësimore: frontale,individuale,në çifte,në grupe. Do të përdorë mjete të ndryshme mësimore: libra të gramatikës, fletëza mësimore,grafoskop etj. Gjatë realizimit të këtyre përmbajtjeve arsimtari duhet të zbatojë punë aktive gjatë orës.</p>	<p>Letërsinë,historinë e gjuhës,dialektologjinë,fonetikën,morfologjinë,fjalorët,leksikonet,sociologjinë,komunikimin etj.</p>

zmat,neologjizmat,profesionallizmat				
Njësitë frazeologjike		* dallon njësitë frazeologjike si: besoj - zë besë, frikësohem - kam frikë, kuptoj - marr vesh etj.		
Fjalorët - llojet	19	*i din fjalorët dhe llojet e tyre. *i dallon dhe i përdor fjalorët e ndryshëm sipas alfabetit- atë drejtshkrimor, shpjegues,dygjuhësor, frazeologjik,sinonimik, të fjalëve të huaja etj.		
II.Morfologji				
Mbiemri		* dallon mbiemrin si përcaktues të emrit,funksionin dhe përshtatjen e tij. * dallon kuptimin dhe ndërtimin e shkallëve krahasore dhe sipërore të mbiemrit.	Për realizimin e kësaj përmbajtjeje arsimtari do të përdorë këto aktivitete: *sqarimin,analizën,sintezën,krahasimin etj. *do të përdorë format mësimore: frontale,individuale,në çifte,në grupe etj. *do të përdorë mjete mësimore: libra të gramatikës,grafoskop, fletëza mësimore,grafikone, episkop,komjuter etj.	Morfologjia,historia e gjuhës,fonetika, dialektologjia etj.
Shkallët e mbiemrit				
Përemrat vetorë		*i dallon përemrat vetorë, kategorinë gramatikore të numrit,gjinisë,rasës, përdorin drejt trajtat e shkurtra të përemrave vetorë në gjuhën e shkruar letrare. *të dijnë t'i dallojnë përemrat dëftorë, t'i përvetësojnë kategoritë gramatikore të numrit,të gjinisë e të rasës.		
Përemrat dëftorë		*i dallon përemrat pronorë, përvetëson kategoritë gramatikore të vetës,	*do të zbatojë metodat: analizën e sintezën,demonstrimin,të tekstit,	

Përemrat pronorë		gjinisë, numrit dhe rasës. *i kupton përemrat pyetës, llojet e tyre dhe zbatimin praktik të tyre.	sintezën,hulumtimin etj.	
Përemrat pyetës		*i dallon përemrat lidhorë, funksionin e tyre,lojet dhe zbatimin e tyre në praktikë.		
Përemrat lidhorë		*të dijë të dallojë përemrat e pacaktuar, funksionin e tyre llojet dhe zbatimin e tyre në praktikë.		
Përemrat e pacaktuar		*të dallojë klasifikimin e ndajfoljeve: ndajfolja përcaktuese,ndajfolja e mënyrës, ndajfolja e sasisë:		
Ndajfoljet		rrethana: e kohës,e vendit,e shkakut,njëherit të përvetsojnë shkallët e tyre (ndajfoljeve).		
Parafjalët		* t'i dallojë parafjalët si pjesë të pandryshueshme të ligjeratës që vihen para pjesëve emërore,zbatimi i tyre i drejtë në praktikë.		
Lidhëzat		* t'i dallojë lidhëzat si fjalë shërbyese për të lidhur dy fjali; lidhëzat me bashkërenditje dhe lidhëzat me nënrenditje, zbatimi i tyre në praktikë.		
Pjesëzat përcaktuese,	11	*t'i dallojë pjesëzat që shërbejnë për të shprehur nuaca kuptimore ose emocionale		

<p>veçuese,zbutës e</p> <p>Pasthirrmat</p> <p>III.Sintaksë</p> <p>Fjalja:Fjalja e thjeshtë dhe e përbërë.</p> <p>Gjymtyrët e dyta të fjalisë-përcaktorët me përshtatje me drejtim</p> <p>Ndajshtimi</p> <p>Rrethorët</p>		<p>plotësuese të një fjale ose fjalie si edhe për të sajuar forma gramatikore (do të, duke, për të - do të shkoj, duke shkuar, për të shkuat).</p> <p>*t'i dallojë pasthirrmat dhe funksionin e tyre.</p> <p>*të dijë të dallojë fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë.</p> <p>*t'i dallojë tipet e fjalisë sipas kumtimit - fjalja dëftore,pyetëse,nxitëse,thirrmore, pohore e mohore, zbatimi i tyre në praktikë.</p> <p>*t'i dijë gjymtyrët e dyta të fjalisë:</p> <p>* t'i dallojë përcaktorët e shprehur me emër, mbiemër,përemër,drejtim dhe numëror.</p> <p>* dallon ndajshtimin e veçuar, funksionin semantik dhe stilistik të tij.</p> <p>*i kupton rrethorët e mënyrës, sasisë, kohës, vendit dhe shkakut, njihet me ndërtimin dhe zbatimin e tyre praktik</p>	<p>Për realizimin e kësaj përmbajtjeje arsimtari do të përdorë këto aktivitete: sqrimin,analizën,sintezën krahasimin,grumbullimin e materialeve etj.</p> <p>*do të përdorë format mësimore: frontale ,individuale,në çifte,në grupe.</p> <p>*do të përdorë mjete mësimore: libra të gramatikës,grafoskop,episkop, fletëza mësimore,tekste të ndryshme etj.Parësor do të jetë mësimi aktiv gjatë realizimit të këtij programi të gjuhës dhe letërsisë shqiptare.</p>	<p>Sintaksa,fonetika, morfologjia,historia e gjuhësisë, dialektologjia, komunikimi etj.</p>
--	--	---	---	---

FUSHA PROGRAMORE : LETËRSIA DHE LEKTYRË (70) orë				
Përmbajtjet	Numri i orëve	Qëllimet konkrete Nxënësit të :	Udhëzime didaktike	Korelacioni mes tërësive tematike dhe lëndëve
LETËRSIA	60			
Letërsia shqipe	37	<p>*i kupton përpjekjet e para për formulimin e kërkesave kulturore të lëvizjes kombëtare “ Enciklika” e N.Veqilharxhit, S. Frashërit dhe vepra “ Shqipëria ç’ka qenë ç’është dhe çdo të bëhet” dhe Kristo Foridhi kontributi për gjuhën.</p> <p>*e dallon letërsinë artistike të Rilindjes sonë Kombëtare, karakteri patriotik demokratik dhe iluminist i saj.</p> <p>*dallon Romantizmin shqiptar dhe tiparet.</p> <p>* dallon tiparet dhe raportet ndërmjet romantizmit dhe realizmit.</p> <p>*Të njihet me jetën dhe aktivitetet letrare të shkrimtarit.</p> <p>*din të bëjë vështrim mbi poemat “ Serafina Topia” dhe “ Skënderbeu i pafan” .</p> <p>*di t’i zbulojë vlerat publicistike të De Radës.</p> <p>*Të njihet me jetën dhe aktivitetin letrar të Darës.</p> <p>*dallon vlerat artistike të poemës “Kënga e Sprasme e Balës”, personazhet, elementet</p>	<p>Kjo temë do të realizohet, duke i përdorur arsimtari këto aktivitete:</p> <p>*interpretimin</p> <p>*shpjegimin</p> <p>*leximin</p> <p>*komentimin</p> <p>*sqarimin</p> <p>*hulumtimin</p> <p>*vrojtimin etj.</p> <p>*Do të zbatojë metodat aktive të punës, në veçanti atë të bisedës, shpjegimit, punës në grupe, në çifte punës me tekst.</p> <p>*Do të përdorë teknikën e anketimit, instrumentin test etj.</p> <p>Koment nga “Kënga e Sprasme e Balës”</p>	<p>Letërsi burimore (letërsia shqipe), letërsia e përkthyer, teori të letërsisë, stilistika, metrika arsimimi qytetarë, komunikimi etj.</p> <p>Histori.</p>
Letërsia e Rilindjes sonë Kombëtare				
Jeronim de Rada				
Gavril Dara				

Zef Serembe		<p>folklorike,gjuhën artistike.</p>		
Anton Santori		<p>*Të njihet me jetën dhe aktivitetin letrar të Serembes. *i kupton lirikën e Serembes dhe elementin e ri që sjell poezia e tij në kuadrin e romantizmit arbëresh. * dallon stilin e Serembes, kompleksitetin e botës shpirtërore.</p>	<p>Komentohet sipas dëshirës: “Vrull”, “Për lirinë e Venetisë”, “Elegji”, “Fytyra e saj”.</p>	
Naim Frashëri		<p>*Të njihet me aktivitetin letrar të Santorit si poet dhe dramaturg,lëvrues i lirikës,poemës, novelës në vargje satirës dhe fabulës.</p>	<p>Të analizojnë dhe komentojnë dramën “Emira”, t’i dallojnë vlerat artistike, dinamizmin e dialogut,lirizmin, humorin.</p>	
Sami Frashëri		<p>*Të njihet me jetën dhe aktivitetin letrar të Naimit. *i dallon veçoritë artistike e filozofike të vëllimit “Lulet e verës”. *Të dallojë jetën baritore dhe idealin patriotik te poema”Bagëti e bujqësi” *T’i dallojë vlerat aristike e gjuhësore,veçoritë e stilit të lirikës së Naimit.</p>	<p>Të analizojnë dhe komentojnë “Historia e Skënderbeu”. Komenton:”Lulet e verës dhe Bagëti e bujqësi “</p>	
Pashko Vasa		<p>*Të njihet me jetën dhe aktivitetin letrar të Samiut dhe veprën e tij. “Shqipëria ç’ka qenë,ç’është dhe ç’do të bëhet” *Të njihet me jetën dhe aktivitetin letrar të Pashko Vasës.</p>	<p>Të komentojnë:”Omoj Shqypni</p>	

<p>Ndre Mjeda</p>		<p>*Të dallojë paraqitjen e jetës shqiptare të kohës në romanin “Bardha e Temalit” *Të dallojnë personazhet, idetë filozofike e shoqërore të romanit kompozicionin etj.</p> <p>*Të njihet me jetën dhe aktivitetin letrar të Mjedës. *e kupton vërtetësinë artistike në paraqitjen e jetës shqiptare të kohës dhe veçoritë artistike të vëllimit “ Juvenilja “. *i dallon veçoritë filozofike dhe të realizmit në paraqitjen e jetës së malësorve shqiptarë të kohës.</p>	<p>dhe Bardha e Temalit”.</p> <p>Të analizojnë dhe komentojnë poemën “Andrra e jetës, Lisus, Shkodra, Liria “. Ti dallojnë vlerat artistike, të kenë kujdes për përsosmërinë e formës, gjuhës artistike.</p>	
<p>Andon Z . Çajupi</p>		<p>*Të njihet me jetën dhe aktivitetin letrar të Çajupit. *i dallon larmitë tematike dhe vëçoritë artistike në përmbledhjen “Baba Tomorri”. *e kupton artin poetik të Çajupit, modelin folklorik, humorin dhe Çajupin si komediograf.</p>		
<p>Aleks S. Drenova (Asdreni)</p>		<p>*Të njihet me jetën dhe aktivitetin letrar të Asdrenit, lirikat e Asdrenit me temë patriotike, shoqërore dhe të dashurisë. *i dallon veçoritë poetike të Asdrenit, përpjekjet për lidhjen me poezinë moderne evropiane. *Të njihen me jetën dhe aktivitetin letrar të shkrimtarit. * e kupton publicistikën e Skiroit, folkloristikën.</p>	<p>Koment “ Lulekuqja”</p>	
<p>Z ef Skiroi</p>			<p>Të analizohet “Te dheu i huaj” tematika dhe vlerat artistike.</p>	

<p>Ndoc Nikaj</p> <p>Letërsi Botërore</p> <p>Rilindja</p> <p>Dante Aligeri</p> <p>Uilliam Shekspiri</p> <p>Miguel de Servantes</p>	<p>23</p>	<p>* Të njihen me jetën dhe aktivitetin letrar, njëherit të njihen se me Nikajn fillon romani shqiptar.</p> <p>*Të njihen me letërsinë botërore, me rilindjen evropiane si lëvizje e rëndësishme kulturore letrare dhe artistike.</p> <p>*Të njihen me jetën dhe aktivitetin letrar të Aligerit.</p> <p>*Jeta dhe aktiviteti letrar i Shekspirit. Të njihen me veçoritë e dramaturgjisë së tij. në</p> <p>*Jeta dhe aktiviteti letrar i Servantesit. Parodizmi i jetës kalorsiake dhe veçoritë filozofike te romani „ Don Kishoti i Manços’’. *Figura e Don Kishotit dhe ajo e Sanço Panços, si mishërim të dy konceptimeve filozofike të kundërta të jetës dhe vlerat artistike të veprës</p>	<p>Të analizojnë fragment nga “Bukurusha”,veçoritë e stilit të shkrimtarit.</p> <p>Të analizojnë këngën 33 nga “Komedia Hyjnore”,të gjejnë subjektin, personazhet, alegori në shoqërore, politike, filozofike dhe fetare të veprës.</p> <p>Të analizojë tragjedinë”Hamleti”, dramaciteti, subjekti, personazhet, vlerat artistike dhe ndërtimi i veprës.</p>	
--	-----------	---	---	--

<p>Klasicizmi</p>		<p>*Të njihet me letërsinë e klasicizmit, parimet estetike dhe kulti i formës në veprat e klasicizmit.</p>		
<p>Rasini</p>		<p>*Jeta dhe aktiviteti letrar i Rasinit.</p>		<p>Letërsi burimore (letërsia shqipe), letërsia e</p>
<p>Molieri</p>		<p>*Jeta dhe aktiviteti letrar i Molierit. Komedia e karaktereve dhe mjetet e komikës te veprat e Molierit.</p>	<p>Analiza e veprës “Andromaka” personazhet si mishërim pasionesh,filozofia e tyre dhe kulti i ndjenjës.</p>	<p>letërsisë, stilistika, metrika arsimimi qytetarë, komunikimi etj.</p>
<p>Romantizmi</p>		<p>*Të njihet me zhvillimin e artit dhe letërsisë në gjirin e lëvizjeve iluministe.</p>		
<p>Johan V. Gëte</p>		<p>*e kupton zhvillimin ekonomik shoqëror të Evropës .</p> <p>*Romantizmi si drejtim letrar, raportet e tij me realizmin dhe simbolizmin.</p>	<p>Të analizohet”Tartufi”, veçoritë e ndërtimit të komedisë.</p>	<p>Histori.</p>
<p>Viktor Hygo</p>		<p>*Jeta dhe aktiviteti letrar si poet, dramaturg, romansier etj.</p>	<p>Të analizohet një fragment nga “Fausti”,veçoritë e tragjedisë, filozofia mbisunduese, personazhet:Fausti,Mefistofeli Margarita.Kompozicioni dhe vlerat artistike.</p>	
<p>Pushkini</p>		<p>*Jeta dhe aktiviteti letrar.</p> <p>*Pushkini si themelues i letërsisë artistike ruse. Vlerat e tij lirike epike dhe dramatike.</p> <p>*Pushkini si poet dhe prozator.</p>	<p>Analizë e një fragmenti “Të mjerët”,personazhet,kompozicioni dhe vlerat artistike.</p>	

Xhorxh. G. Bajroni		*Jeta dhe aktiviteti letrar.	Komentohehet një fragment nga “Eugjen Onieginii”, stili, gjuha, personazhet dhe vlerat artistike. Analizë e poemës “Çajld Harold”, vlerat artistike.	
-------------------------------	--	-------------------------------------	---	--

LISTA E LEKTYRAVE

JUSUF BUXHOVI	10 orë	SHËNIMET E GJ. N. KAZASIT	<p>Nxënësit të njihen me veprat më të rëndësishme të letërsisë shqipe dhe asaj botërore që janë në listën e lektyrave.</p> <p>Të aftësohen t'i vlerësojnë vlerat pozitive të veprave letrare në aspekt të përmbajtjes dhe formës.</p> <p>Posaqërisht t'i analizojnë idetë e autorit në raport me kohën, vendin dhe temën që trajton.</p> <p>Gjatë vitit të analizohen 7-8 vepra nga lista e paraparë sipas zgjedhjes së arsimtarit dhe nxënësve.</p>
DHIMITËR XHUVANI		E NESËRMJA E NJË GRUAJE	
NAIM FRASHËRI		HISTORIA E SKËNDERBEUT	
ODISE GRILLO		DON KISHOTI	
MOLIERI		TARTUFI	
SHEKSPIRI		HAMLETI	
S. SPASE		AFËRDITA	
R. SURROI		BESNIKU	
YMER SHKRELI		URA E XHEHNEMIT	
ERNEST KOLIQI	TREGTAR FLAMUJSH		

4.2. Metodat mësimore dhe aktivitetet për mësim

Metodologjia e propozuar e mësimet bazohet në supozimin se gjuha shqipe përdoret si lëndë mësimore , gjer në shkallën më të lartë të arsimimit. Arsimitari patjetër të aplikojë metoda funksionale të mësimet, me theks të veçantë në aktivitetet e nxënësve, që bazohen në interesimin e tyre me qëllim që të krijohen kushte të volitshme për mësim. Nga metodat mësimore propozojmë të përdorë para së gjithash atë të bisedës, shpjegimit demonstrimit, punës me tekst etj.

Të respektojë karakterin shkencor të të mësuarit, sistematizimin si dhe të përpiqet të vërë në zbatim lidhjen e teorisë me praktikën. Sa i takon gjuhës është e rëndësishme që në mënyrë permanente të shkohet nga niveli funksional nga ai sistematik, me qëllim që të ruhet motivimi i nxënësve për zbatimin e gjuhës letrare shqipe .

T'u mundësohet nxënësve sa më shumë që është e mundur, ta shfrytëzojnë gjuhën shqipe në kontekst funksional, si të arriturat si të arriturat gjuhësore ashtu edhe ato letrare me qëllim që të mundësohet aplikimi i tyre.

Nga format e punës është e udhës që pos formës frontale të përdoret edhe ajo në grupe, individuale dhe në çifte. Po ashtu gjatë realizimit të materialit mësimor arsimtari duhet të përdor sa më shumë mjete mësimore vizuale (libra, fletëza mësimore, pyetësor revista për të rinj), teknikë (kompjuter, televizor, video, magnetofon, me anë të të cilëve vë në shprehje aktivitetet e nxënësve.

Tema të tëra duhet të realizohen me anë të sistemit problemor, kërkimor aktiv të të mësuarit. Kështu aktivitetet e nxënësve do të gjejnë shprehje përmes: vrojtimit, dëgjimit, shënimit, ushtrimeve, leximit, zgjidhje të problemeve , qoftë ajo në formë grupore apo individuale, duke gjetur shprehje puna e pavarur e nxënësve.

Aktiviteti i nxënësit: interesohet,parashtron pyetje,shpreh mendimin e tij,propozon zgjidhje,vështron,zbulon (ndryshime)

evidenton të dhëna,kontrollon,diskuton,përputh mendimet me anëtarët e grupit.

Aktiviteti i arimtarit: planifikon,bën përgatitje(hapsinorë,mjetet mësimore dhe didaktiko metodike),parashtron problemin,

jep kahje,vështron,ndihmon,koordinon dhe e vështron punën e grupeve dhe individëve,jep informata,demonstron,përcjell, vlerëson(punën e vet dhe të grupit),ven kontakt pozitiv pedagogjik duke komunikuar me nxënësit dhe arsimtarët.

4.3. Organizimi dhe realizimi i procesit mësimor

Sipas qëllimit të parashtruar, lënda mësimore, realizohet në mësojtore të specializuar për mësim teorik, në dy gjysmëvitet, me orë javore, të detyrueshme. Puna e pavarur e nxënësve mund të realizohet në shkollë dhe në shtëpi si detyrë shtëpie.

4.4. Mjetet mësimore dhe ato ndihmëse

Për t'u realizuar qëllimi i lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsisë me komunikim në shkollat e mesme të gjimnazit i propozojmë mjetet mësimore:

1. Pajisjet e rëndomta: bankat, karriget, dërrasat (tabelen).
2. Grafoskopin (mund të jetë i përbashkët për më shumë lëndë mësimore)
3. Vende për një ruajtje të sigurt të completeve të paraleles dhe të librave me referenca (dollape, rafte).
4. Përdorimi i internetit në hapësirat ku janë të instaluar kompjuterët.
5. Kasetofoni dhe videorekorderi ...(TV mund të jetë i përbashkët).

Gjatë realizimit të programit të lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë me komunikim, nxënësve dhe arsimtarëve u sugjerohen librat dhe materialet:

1. Libri i leximit (viti i dytë).
2. Libri i gramatikës me komunikim (viti i dytë).
3. Teksti i teorisë së letërsisë dhe folklorit (viti i dytë).
4. Doracaku për nxënësit.
5. Doracaku për mësuesin.
6. Kopje të librave të sipërpërmendura dhe materiale për përdorim personal.
7. Parapagimi (përmes shkollës) i revistave të vlefshme profesionale.
8. Katalogë të materialeve për mësimin e metodikës së gjuhës dhe letërsisë.
9. Përdorimi i fotokopjes dhe aparateve të tjera për shtypje.

5. Notimi dhe rezultatet e nxënësve

Nxënësit do të notohen në mënyre permanente gjatë tërë vitit dhe punës, testimi ekstern për notimin permanent, nxënësi duhet të vlerësohet me 8 nota gjatë vitit shkollor. K y numër i notave parashihet për dy semestra. Gjatë gjysëm vitit të parë, 2 nota do të bazohen në teste dhe detyra të kontrollit, 4 nota do të bazohen në fushën e komunikimit dhe 2 nota do të jenë të hartimeve.

Aspekti gramatikor dhe ai i drejtshkrimit të gjuhës vlerësohet përmes testeve dhe detyrave të kontrollit.

Gjatë kontrollimit të njohurive të nxënësve me anë të testit, në rast mospasjes, ato i nënshtrohen riprovimit.

6. PARAKUSHTET MATERIALE DHE KADROVIKE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË LËNDËS

6.1. Karakteristikat themelore të arsimtarit

Arsimtari i lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi me komunikim duhet të posedojë.

karakteristika personale, profesionale dhe pedagogjike të cilat janë:

- * të jetë i shëndoshë fizikisht dhe psikikisht,
- * të njohë gjuhën letrare shqipe dhe shkrimin e saj,
- * të mos ketë pengesa në të shprehurit gojor,
- * të jetë komunikativ dhe i hapur për bashkëpunim,
- * të ketë përgatitje përkatëse profesionale, me ose pa përvojë pune,
- * ta dojë punën pedagogjike dhe të perparojë në këtë profesion,
- * të jetë organizator i mirë, kreativ dhe i aftë për të zbatuar risi në metodologjinë mësimore etj .

6.2. STANDARDI I KUADRIT MËSIMDHËNËS

Lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqiptare në gjimnaze mund ta mbajnë mësimdhënësit që kanë kryer:

1. Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare (drejtimi arsimor)
2. Fakultetin Filozofik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare (drejtimi arsimor)
3. Fakultetin Filozofik, Grupin e Letërsisë shqiptare dhe Gjuhës (drejtimi arsimor)

6.3. Standardi hapsinor

Për ta arritur qëllimin e parashikuar lënda Gjuhë shqipe dhe letërsi me komunikim duhet të realizohet në mësojtore të specializuara, ose kabinet i dedikuar për këtë lëndë mësimore.

7. DATA E PËRGATITJES DHE BARTËSI I PROGRAMIT

7.1. Data e hartimit të programit -----

maj 2002

7.2. Përbërja e grupit punues:

1. Selver Ramadani- këshilltar në Byronë për Zhvillimin e Arsimit-bartës
2. Dr. Zeqir Kadriu- zëvendës drejtor në Byronë për Zhvillimin e Arsimit.
3. Dr. Xhemaludin Idrizi- prof. i gjuhës dhe letërsisë shqiptare (drejtor në Gjinnazin " Zef Lush Marku" Shkup).
4. Dr. Merlinda Krifca - profesor në Fakultetin Filologjik, Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe - Shkup.
5. Dr. Remzi Nesimi – prof. në Fakultetin Filologjik –Katedra e gjuhës dhe letërsisë shqipe-Shkup
6. Qamile Saiti - profesoror në gjinnazin " Zef Lush Marku " Shkup.
7. Fatmir Sulejmani - këshilltar në Byronë për Zhvillimin e Arsimit- Tetovë.

8. FILLIMI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

9. MIRATIMI I PROGRAMIT MËSIMOR

Programi i lëndës Gjuhë Shqipe dhe Letërsi u lejua të përdoret me vendimin numër _____ të datës _____ viti 2002

